

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.133/2015 “PËR TRAJTIMIN E PRONËS DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË KOMPENSIMIT TË PRONAVE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi i këtij projektligji vjen në kuadër të adresimit të problematikave të evidentuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronës gjatë zbatimit të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar. Këto problematika lidhen me pamundësinë e kësaj Agjencie për të përmbyllur procesin e shqyrtimit të kërkesave dhe të kompensimit brenda afatit të vendosur me ligjin nr.77/2022, përmes të cilit ky afat u vendos në 31.12.2024. Kjo pamundësi ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh objektivë të brendshëm dhe të jashtëm.

Qëllimi i projektaktit të propozuar është rihapja e afatit të shqyrtimit të kërkesave në rrugë administrative nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronës deri në vitin 2027 dhe shtyrja e afatit për shpërndarjen e vlerës së kompensimit financiar deri në vitin 2028.

Përmes këtyre ndryshimeve mundësohet arritja e objektivave të mëposhtme:

- Dhënia e mundësisë së qytetarëve që kërkesat e tyre të shqyrtohen në rrugë administrative nga ATP në një kohë më të shkurtër, krahasuar me kohën që do të shpenzohej në rast të shqyrtimit të tyre nga juridiksioni gjyqësor;
- Përcaktimi i një afati objektiv dhe të arsyeshëm, bazuar në evidenca statistikore, për përfundimin e procesit të kompensimit të pronave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektakt është në përputhje me objektivin e Këshillit të Ministrave për të përmbyllur procesin e trajtimit të pronave nëpërmjet njohjes dhe kompensimit të pronave të subjekteve, brenda afateve objektive dhe të realizueshme.

Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me Programin Politik të Qeverisë 2021 – 2025 lidhur me vijimin e proceseve të rëndësishme për të garantuar sigurinë e pronës, por nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2024, miratuar me vendimin nr.790, datë 28.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Qëllimi kryesor i projektligjit është adresimi i problematikave të evidentuara nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronës sa i përket përmbylljes brenda datës 31.12.2024 të procesit të shqyrtimit të kërkesave dhe kompensimit të subjekteve përfituese nga ligji nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar.

Në përputhje me ndryshimet ligjore të vitit 2022 në ligjin nr.133/2015, procesi i shqyrtimit të dosjeve, që janë aplikuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në proces shqyrtimi pranë Agjencisë, përfundon brenda datës 31.12.2024. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe akteve nënligjore, Agjencia e Trajtimit të Pronave filloi hetimin administrativ për shqyrtimin e 7000 dosjeve të patrajuara për njohje pronësie, për të cilat ka kryer procedurat e njoftimit të subjekteve për plotësim dokumentacioni. Aktualisht, rezulton se ATP ka në proces shqyrtimi 5862 dosje dhe 1197 praktika, në total 7059, nga të cilat 705 dosje/praktika të rikthyera për trajtim.

Në lidhje me procesin e vendimmarrjes, ATP ka përmbyllur aktualisht procedimin administrativ, duke marrë vendim për 115 dosje ose 1.6% të kërkesave ende të patrajuara, ndërsa ka filluar procedurat e njoftimit për plotësim dokumentacioni për rreth 2900 kërkesa për njohje pronësie ose 41.4% të dosjeve/praktikave.

Kohëzgjatja e trajtimit të një dosje/praktike dhe nxjerrja e një vendimi kushtëzohet nga faktorë të brendshëm siç janë eksperiencia dhe efica e inspektorit që ka në trajtim dosjen/praktikën, volumi i dokumentacionit të administruar, kompleksiteti dhe natyra e dokumentacionit. Ky proces kushtëzohet dhe nga faktorë të jashtëm siç janë procedurat e njoftimit, plotësimi i dokumentacionit nga subjekti, konfirmimi i informacionit nga institucionet e treta dhe nevojat e hetimit administrativ të cilat rast pas rasti diktojnë edhe nevojën për këqyrjen në vend të provës pranë palëve të treta, përfshirë këtu edhe verifikimin fizik në terren. Duke marrë në konsideratë këto rrethana, si dhe parashikimet ligjore lidhur me afatet e përfundimit të procedimit administrativ, vlerësohet se koha për marrjen e një vendimi është nga 3 deri në 6 muaj për dosje.

Ky afat nuk merr në konsideratë ato situata, kur plotësimi i dokumentacionit nga ana e subjektit do të kryhet në rrugë gjyqësore, pasi në këto raste procedimi administrativ pezullohet deri në zgjidhjen e çështjes paraprake nga ana e gjykatës, ku në mjaft raste, koha e gjyqimit ka tejkaluar edhe afatin e juridiksionit administrativ të ATP-së.

Duke marrë në konsideratë kohën e mbetur në dispozicion, referuar treguesve të performancës, kapaciteteve të burimeve njerëzore, kompleksitetit të procedimit si dhe kërkesave ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, paraprakisht vlerësohet se objektivi ligjor për trajtimin e plotë të dosjeve të patrajuara brenda datës 31.12.2024, nuk mund të realizohet. Këto përfundime, mbështeten në faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët kanë kushtëzuar vendimmarrjen e ATP-së, duke projektuar si objektivi të arritshëm maksimalisht rreth 700 vendime deri në fund të vitit 2024, ose 10% të dosjeve të patrajuara.

Sa më sipër rezulton e domosdoshme ndërhyrja legislative në ligjin nr.133/2015, të ndryshuar, përmes këtij projektligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, si dhe rendin juridik të brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 6 dispozita, përmbajtja e të cilave sqarohet si vijon:

Në nenin 1 të projektligjit përcaktohet ndryshimi i afatit të shtrirjes në kohë të fondit të kompensimit deri në vitin 2028. Aktualisht, sipas parashikimeve ligjore, fondi i kompensimit prej 50 miliardë lekësh është i shpërndarë në 10 vite pas hyrjes në fuqi të ligjit, pra deri në vitin 2026.

Kjo shtyrje diktohet nga një sërë faktorësh:

- Shtyrja e afatit për shqyrtimin e kërkesave deri në 31.12.2027, sipas projektligjit të propozuar;
- Në përputhje me ligjin nr.133/2015, të ndryshuar, Agjencia e Trajtit të Pronave është e ngarkuar për zbatimin e vendimeve kur ato të marrin formë përfundimtare në kuptim të ligjit, sa i takon vlerësimin financiar të së drejtës së kompensimit apo për ekzekutimin e vlerësimin sipas vendimit gjyqësor.
- Back log-u i dosjeve pranë sistemit gjyqësor;
- Ecuria e proceseve gjyqësore dhe qëndrimit të gjykatave, të cilat përsa i takon trajtimit të kërkesave për njohje pronësie nuk kanë proceduar në të gjitha rastet edhe me vlerësimin financiar të së drejtës së njohur, shtyrja e afatit të vlerësimin financiar deri në vitin 2027, krijon kushtet për vlerësimin financiar të titujve ekzekutiv gjyqësor nga ana e ATP-së.

Pra, në përputhje me këtë dispozitë, ATP-së i krijohet mundësia që të vijojë me ekzekutimin e vendimeve dhe kompensimin deri në 31.12.2028.

Në nenin 2 të projektligjit parashikohet shtyrja e afatit të kryerjes së vlerësimin financiar nga ATP deri në 31.12.2027. Aktualisht, me ndryshimet ligjore të vitit 2022 ky afat u caktua 31.12.2024. Megjithë përpjekjen e ATP-së për respektimin e këtij afati, një sërë faktorësh të

brendshëm dhe të jashtëm bënë të pamundur objektivisht arritjen e tij. Konkretisht, paraqesim në mënyrë të përmbledhur faktorët që diktojnë shtyrjen e afatit:

- Hyrja në fuqi e ligjit nr.77/2022 dhe miratimi akteve nënligjore që mundësojnë funksionimin dhe zhvillimin e punës së ATP-së;
- Procedura dhe afatet kohore që parashikon ligji për njoftimin e subjekteve për plotësimin e dokumentacionit kanë krijuar një hallkë të re procedurale që kërkon respektimin e afateve të caktuara;
- Procesi i bashkërendimit dhe koordinimit ndërinstitucional;
- Procesi i shqyrtimit të kushtetutshmërisë së ligjit nr.77/2022 nga Gjykata Kushtetuese dhe vendosja prej saj e masës së pezullimit të ligjit sollën si pasojë pezullimin e veprimtarisë së ATP-së për një periudhë 3 mujore;
- Struktura administrative e pamjaftueshme për trajtimin e volumit të madh të dosjeve.

Përmes projektligjit të propozuar, referuar të dhënave të ATP-së, duke marrë në konsideratë disponibilitetin e plotë të burimeve dhe efektivitetin e plotë të orëve të punës, vlerësohet se numri maksimal i vendimeve që mund të realizohet mesatarisht përgjatë një viti kalendarik është 2500 vendime. Kjo analizë krijon premisa për përfundimin e procesit brenda një afati 3 vjeçar.

Neni 3 i projektligjit parashikon ndryshimin e nenit 16 të ligjit nr.133/2015, të ndryshuar, në kuadër të arritjes së qëllimit për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të vendimeve deri në 31.12.2028.

Në nenin 4 të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 34 të ligjit nr.133/2015, të ndryshuar, në kuadër të arritjes së qëllimit për shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesave deri në 31.12.2027.

Neni 5 i projektligjit parashikon ndryshimin e shtojcës 2 të ligjit nr.133/2015, të ndryshuar. Në këtë shtojcë pasqyrohet tabela me shpërndarjen e vlerës së fondit të kompensimit, e shtrirë në 10 vite nga hyrja në fuqi e ligjit nr.133/2015, të ndryshuar. Në kushtet kur qëllimi i projektligjit është shtyrja e afatit të shqyrtimit të kërkesave deri në 31.12.2027 dhe ekzekutimit të vendimeve deri në 31.12.2028 është e domosdoshme të rishikohet edhe tabela lidhur me fondin e kompensimit për periudhën që nuk është alokuar ende. Pra, konkretisht nuk është alokuar ende viti i 10, ndaj vlera që i takon këtij viti sipas tabelës aktuale, është rishikuar duke u shpërndarë në 4 vite, por pa shtuar koston për buxhetin e shtetit. Pra, fondi i kompensimit mbetet 50 miliardë lekë, por vetëm është rishikuar shpërndarja e vlerës së mbetur e pa alokuar.

Neni 6 i projektligjit parashikon se ky projektligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektakti ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe subjektet përfituese sipas ligjit nr.133/2015.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave.

Projektligji do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Financave, Avokaturës së Shtetit dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe do t'i nënshtrohet një procesi të gjerë konsultimi me grupet e interesit dhe ekspertë të fushës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shitesë për buxhetin e shtetit, përtej atyre të parashikuara nga ligji nr.133/2015, i ndryshuar.

MINISTRI

Ulsi Manja